



Korçë, më 25 / 02 / 2026

Lënda: Kërkesë për pajisje me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismë ligjore qytetare

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi Komisionar Shtetëror i Zgjedhjeve

Nga: Komiteti Nismëtar për Projektligjin:

**PËR FINANCIMIN SHETETËROR TË TRAJTIMEVE SHËNDETËSORE TË
SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT, BRENDË OSE JASHTË VENDIT, KUR ATO NUK
OFROHEN NGA SISTEMI PUBLIK I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Përfaqësuar nga:

Z. Ardit Konomi

Nr. ID: H10421079Q

Tel: +355 682054724

Email: arditkonomi@gmail.com

I nderuar z. Celibashi

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të Ligjit nr. 54/2019, "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, neni 10, Komiteti Nismëtar që përfaqësojmë ju paraqesim kërkesën, për paraqitjen e projektligjit:

**PËR FINANCIMIN SHETETËROR TË TRAJTIMEVE SHËNDETËSORE TË
SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT, BRENDË OSE JASHTË VENDIT, KUR ATO NUK
OFROHEN NGA SISTEMI PUBLIK I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve për nisma ligjore qytetare, ju lutemi të na pajisni me "fletët tip zyrtare", për mbledhjen e nënshkrimeve.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë paraqesim:

- * Aktin e themelimit të Komitetit Nismëtar;
- * Vendimin për caktimin e përfaqësuesit ligjor;
- * Listën e anëtarëve të Komitetit;
- * Kopje të dokumenteve të identifikimit të anëtarëve;
- * Tekstin e plotë të projektligjit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj zyrtare.


Me respekt,

Për Komitetin Nismëtar

Ardit Konomi

Përfaqësues Ligjor

Firma:



AKT THEMELIMI I KOMITETIT NISMËTAR PËR NISMËN LIGJORE QYTETARE

Korçë, më 25/02/2026

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 dhe nenit 82 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Ne, shtetasit e poshtëshënuar:

Nr	Emër Mbiemër	Atësia	Datëlindja	Nr. ID	Adresa
1	Ardit Konomi	Petrika	21.04.1971	H10421079Q	Blv.Gjergj Kastrioti, B3/A, Korçë
2	Ardit Baliko	Nevrus	17.03.1979	H90317059K	Rr.Kajo Babieni, L4, Nr 11, Korçë, Shqipëri
3	Ardi Duro	Nesti	29.06.1982	I20629082P	Rr.Thanas Mërtiri, L4, Nr.24, Korçë, Shqipëri
4	Çiljeta Simaku	Nesim	16.05.1976	H65516083O	Rr.Jorgo Plaku, N34, H1, Korçë, Shqipëri
5	Ereandra Robo	Shkelqim	16.09.1984	I45916075C	Rr.Midhi Kostani, L9, P12, Korçë, Shqipëri
6	Evis Miço	Naumaq	16.05.1975	H55516143V	Rr.Ptoleme Xhuvani, L1, B26, H1/7, Korçë, Shqipëri
7	Ildi Theodhor	Naumaq	30.12.1979	H91230071B	Rr.Koço Camçe, Nr.20,

					Korçë, Shqipëri
8	Klajdi Pllaha	Petrika	08.09.1989	I90908083D	Rr.Koço Stralla, L11, Nr.21, Korçë, Shqipëri
9	Klevis Qafzezi	Gjergji	25.10.1978	H81025031K	Blv.Gjergj Kastrioti, P8, H6/7, Korçë, Shqipëri
10	Koço Kërëku	Thimaq	28.05.1978	H80528036J	Rr.Vasil Tromara, L12, Nr.35, Korçë, Shqipëri
11	Ledia Bonja	Anesti	23.05.1981	I15523090F	Rr.Fuat Babani, L1, B6/11, Korçë, Shqipëri
12	Leonard Olli	Nesim	25.10.1965	G51025155N	Rr.Kiço Greço, L8, P69, Korçë, Shqipëri
13	Manjola Arnautu	Nikolla	03.07.1982	I25703081F	Rr.Kongresi i Përmetit, L1, Korçë, Shqipëri
14	Misenva Shtylla	Gjergji	16.09.1990	J05916122B	Rr.Thanas Mërtiri, L12, Nr.4, Korçë, Shqipëri
15	Nertil Demiraj	Skënder	25.11.1984	I41125066C	Rr.Viktor Eftimiu, L14, P11, Korçë, Shqipëri

vendosim:

Krijimi i Komitetit Nismëtar

Krijohet Komiteti Nismëtar për Nismën Ligjore Qytetare me emërtimin:

Komiteti Nismëtar për Projektligjin për;

**PËR FINANCIMIN SHETETËROR TË TRAJTIMEVE SHËNDETËSORE TË
SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT, BRENDË OSE JASHTË VENDIT, KUR ATË NUK
OFROHEN NGA SISTEMI PUBLIK I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Neni 2

Objekti i Veprimtarisë

Komiteti Nismëtar ka për objekt:

- a) Organizimin e Nismës Ligjore qytetare;
- b) Hartimin përfundimtar të projektligjit;
- c) Organizimin e mbledhjes së firmave të qytetarëve;
- d) Përfaqësimin e Nismës pranë institucioneve shtetërore;
- e) Dorëzimin e projektligjit në Kuvend.

Neni 3

Qëllimi i Nismës

Qëllimi i kësaj nisme është miratimi i projektligjit:

**PËR FINANCIMIN SHETETËROR TË TRAJTIMEVE SHËNDETËSORE TË
SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT, BRENDË OSE JASHTË VENDIT, KUR ATË NUK
OFROHEN NGA SISTEMI PUBLIK I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

i cili synon garantimin e aksesit universal dhe të barabartë në trajtim shëndetësor për shtetasit shqiptarë, veçanërisht për të porsalindurit dhe fëmijët me sëmundje të rënda.

Neni 4

Përbërja e Komitetit

Komiteti përbëhet nga 15 anëtarë themelues, të cilët janë njëkohësisht edhe nismëtarë të projektligjit.

Lista e anëtarëve bashkëlidhet pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 5

Përfaqësimi Ligjor

Komiteti Nismëtar autorizon:

Z. Ardit Konomi

Nr. ID: 036786387

si Përfaqësues Ligjor të Komitetit për:

- komunikimin zyrtar me institucionet;
- depozitimin e projektligjit;
- dorëzimin e firmave;
- ndjekjen e procedurave parlamentare.

Neni 6

Vendimmarrja e Brendshme

Vendimet e Komitetit merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.





Neni 7

Kohëzgjatja

Komiteti ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e shqyrtimit të nismës ligjore në Kuvend.

Firmosur në Korçë, më datë 25 / 02 / 2026

Nënshkrime:

Nr	Emër Mbiemër	Nënshkrimi
1	Arshi Koman	
2	Ardit Balika	
3	Artur Duro	
4	Çiljeta Simaku	
5	Enxhonda Roko	
6	Enis Aliu	
7	Idri Memollon	
8	Klajdi Pllaha	
9	Klervis Qafzezi	
10	Krasno Krasen	
11	Ledia Bonja	
12	Leonard Ali	
13	Momjda Anaku	

14	Miscuna Shitylla	
15	Mertik Dominoy	







DEKLARATË E PËRBASHKËT E NISMËTARËVE

Ne, anëtarët e Komitetit Nismëtar, deklarojmë se:

- Jemi shtetas shqiptarë me të drejtë vote;
- Mbështesim plotësisht projektligjin e propozuar;
- Angazhohemi të veprojmë në përputhje me ligjin dhe parimet e transparencës.

Firmosur në Korçë, më datë 25 / 02 / 2026

Nënshkrime:

Nr	Emër Mbiemër	Nënshkrimi
1	Devis Vismiri	
2	Ardit Baliko	
3	Ardi Duro	
4	Ciljeta Simaku	
5	Enxhonda Holo	
6	Enis Aliu	
7	Flori Neodbo	
8	Klajdi Pllaha	
9	Klervis Qafzezi	
10	Kos Kereku	
11	Ledia Zonja	
12	Merced Uli	
13	Momjda Armanu	
14	Museva Shylla	
15	Mustif Deminog	

PROJEKTLIGJ

PËR FINANCIMIN SHTETËROR TË TRAJTIMEVE SHËNDETËSORE TË SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT, BRENDË OSE JASHTË VENDIT, KUR ATË NUK OFROHEN NGA SISTEMI PUBLIK I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 55, nenit 81 dhe nenit 82 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 24 të Konventa për të Drejtat e Fëmijës, ratifikuar me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991, si dhe të nenit 21 të ligjit nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", me propozimin e 20,000 zgjedhësve,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyrën e financimit nga shteti të trajtimit shëndetësor të specializuar për shtetasit shqiptarë të grupmoshës 0–18 vjeç, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, kur trajtimi përkatës nuk ofrohet nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor.

Neni 2

Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është:

- a) garantimi i së drejtës për trajtim shëndetësor të specializuar dhe në kohë për fëmijët 0–18 vjeç;
- b) mbrojtja e jetës dhe shëndetit të fëmijëve;
- c) sigurimi i barazisë në akses ndaj trajtimit shëndetësor të specializuar.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj, termat kanë këto kuptime:

Arsyeshmëria ekonomike - është kriteri sipas të cilit financimi nga fondet publike miratohet vetëm kur kostoja e ndërhyrjes është e justifikuar në raport me përfitimin e pritshëm, duke garantuar përdorim racional dhe proporcional të burimeve buxhetore.

Fond i Veçantë – fondi i parashikuar në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mbulimin e shpenzimeve sipas këtij ligji.

Fond rezervë – fondi që kërkohet sipas ligjit për buxhetin, në rast pamjaftueshmërie të Fondit të Veçantë.

Institucione të kujdesit shëndetësor publik – të gjitha institucionet publike që ofrojnë shërbime spitalore në Republikën e Shqipërisë.

Institucione të kujdesit shëndetësor jopublik – institucionet shëndetësore private të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.

Komisioni për Trajtimin Shëndetësor të Specializuar (KTSHS) – organi kolegjal shqyrtues dhe vendimmarrës për rastet objekt i këtij ligji.

Rasti - është çdo praktikë mjekësore që përcakton nevojën e pacientit për trajtim shëndetësor të specializuar.

Proporcionalitet – vlerësimi juridik dhe mjekësor që garanton balancë të drejtë ndërmjet mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të fëmijës dhe përdorimit të arsyeshëm të fondeve publike, mbi bazë domosdoshmërie, përshtatshmërie dhe proporcionaliteti në kuptimin e ngushtë.

Sistemi i Kujdesit Shëndetësor Publik - është tërësia e institucioneve publike që ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

Strukturë Administrative Përgjegjëse - është struktura që do ndjekë dhe zbatojë procesin pas vendimmarrjes të Komisionit për Trajtimin Shëndetësor të Specializuar, KTSHS.

Subjekt përfitues – fëmija 0–18 vjeç që plotëson kushtet e këtij ligji.

Trajtim shëndetësor i specializuar – trajtim mjekësor që kërkon kompetenca, teknologji ose kapacitete që tejkalojnë shërbimin bazë shëndetësor.

Neni 4

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Interesi më i lartë i fëmijës është parësor në çdo vendimmarrje sipas këtij ligji.
2. Dispozitat e këtij ligji interpretohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
3. Në rast dyshimi mbi interpretimin e kriterëve të proporcionalitetit, interpretimi që garanton mbrojtje më efektive të jetës dhe shëndetit të fëmijës ka përparësi për sa kohë nuk cënohet në mënyrë të pajustificuar interesi publik financiar.
4. Çdo refuzim i së drejtës për financim duhet të jetë i arsyetuar, i nevojshëm dhe proporcional në kuptim të këtij ligji.

Neni 5

Parimi i proporcionalitetit

1. Shteti garanton mbulimin e shpenzimeve për trajtimin shëndetësor të specializuar për fëmijët, kur trajtimi i nevojshëm nuk ofrohet nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor brenda vendit.
2. Vendimmarrja për financimin bazohet në analizën e këtyre kriterëve:
 - a) nevojës jetike dhe urgjencës së trajtimit;
 - b) përfitimit terapeutik të pritshëm për jetën ose shëndetin e fëmijës;
 - c) mungesës së alternativave efektive brenda sistemit publik të kujdesit shëndetësor;
 - ç) raportit ndërmjet kostos së trajtimit dhe përfitimit klinik të pritshëm, në përputhje me parimin e arsyeshmërisë ekonomike.
3. Vlerësimi i proporcionalitetit kryhet rast pas rasti nga KTSHS, mbi bazë të dokumentacionit mjekësor të plotë dhe vlerësimit financiar të dokumentuar të kostos të trajtimit, duke shqyrtuar në mënyrë të arsyetuar raportin ndërmjet kostos, përfitimit klinik, urgjencës së ndërhyrjes dhe alternativave terapeutike të disponueshme.

Neni 6

Kriteret e vlerësimit të rastit

Vlerësimi përfshin analizën e:

- diagnozës dhe prognozës mjekësore;
- urgjencës së ndërhyrjes;
- probabilitetit të suksesit;
- kostos në raport me standardet e praktikës mjekësore;
- ekzistencës së alternativave terapeutike.

Neni 7

Subjektet përfituese

Përfitues janë të gjithë fëmijët nga 0–18 vjeç.

Neni 8

Kushtet për financim të trajtimit shëndetësor të specializuar brenda ose jashtë vendit

Trajtimi shëndetësor i specializuar brenda ose jashtë vendit, financohet nga shteti kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

- a) diagnoza është e konfirmuar ose e papërcaktueshme nga institucioni publik shëndetësor;
- b) trajtimi nuk ofrohet nga sistemi publik shëndetësor shqiptar;
- c) mungesa ose vonesa e trajtimit rrezikon jetën ose shëndetin e pacientit;
- ç) ekziston rekomandim i argumentuar mjekësor.

Neni 9

Komisioni për Trajtimin Shëndetësor të Specializuar (KTSHS)

Pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale krijohet KTSHS.

Komisioni përbëhet nga:

- 3 mjekë specialistë sipas fushës përkatëse ose atyre të ndërlidhura;
- 1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- 1 përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- 2 ekspertë ad hoc për raste diagnozash të rralla dhe specifike.

Anëtarët deklarojnë mungesën e konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi.

Përbërja dhe funksionimi i këtij Komisioni rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Roli dhe përgjegjësitë e KTSHS

KTSHS brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, ka përgjegjësinë:

- Të shqyrtojë rastin e referuar nga institucioni publik i kujdesit shëndetësor;
- Të verifikojë mundësinë e trajtimit të rastit brenda sistemit publik të kujdesit shëndetësor;
- Të vendosë për trajtim në sektorin jopublik brenda vendit, kur rasti nuk mund të trajtohet brenda sistemit publik të kujdesit shëndetësor;
- Të vendosë për trajtim jashtë vendit kur nuk ekziston alternativë tjetër.

Neni 11

Vënia në lëvizje e KTSHS

Vënia në lëvizje e KTSHS, bëhet nga institucioni publik i kujdesit shëndetësor që ka trajtuar rastin, brenda 24 orëve nga momenti kur konstatohet pamundësia e trajtimit brenda sistemit publik të kujdesit shëndetësor.

Neni 12

Procedura dhe afati i vendimmarrjes së KTSHS

K.T.SH.S. shqyrton kërkesën dhe merr vendim:

- brenda 3 ditëve kalendarike nga vënia në lëvizje, për rastet e zakonshme;
- brenda 48 orëve nga vënia në lëvizje, për rastet urgjente.

Vendimi arsyetohet dhe i komunikohet menjëherë familjes ose përfaqësuesit ligjor si dhe organit të caktuar për zbatim.

Neni 13

Procedura e përshpejtuar në rast rreziku për jetën

1. Kur nga dokumentacioni mjekësor rezulton rrezik i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm për jetën ose rrezik i pakthyeshëm për shëndetin e fëmijës, kërkesa trajtohet me procedurë të përshpejtuar.
2. Në procedurën e përshpejtuar:
 - a) Komisioni mbledhet brenda 24 orëve nga vënia në lëvizje;
 - b) vendimi merret jo më vonë se 48 orë nga vënia në lëvizje;
 - c) vendimi mund të merret edhe mbi bazë dokumentacioni elektronik në raste të jashtëzakonshme.

3. Vlerësimi në procedurë të përshpejtuar i nënshtrohet të njëjtave kritere proporcionaliteti, duke marrë në konsideratë prioritetin e mbrojtjes së jetës dhe shmangien e dëmit të pakthyeshëm.
4. Mosrespektimi i afateve përbën shkelje disiplinore dhe administrative sipas legjisllacionit në fuqi.

Neni 14

Struktura administrative zbatuese e vendimit të KTSHS.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ngarkohet për ngritjen dhe funksionimin e një strukture administrative përgjegjëse, për zbatimin e vendimit të KTSHS.

Neni 15

Kompetencat e strukturës administrative përgjegjëse

Struktura administrative përgjegjëse për zbatimin e vendimmarrjes të KTSHS , ka për detyrë:

- Të marrë informacion dhe të gjejë klinikat që ofrojnë shërbimin shëndetësor të specializuar, duke shfrytëzuar me përparësi, marrëveshjet dy ose shumëpalëshe që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka në fushën e shëndetësisë, me shtete të tjera.
- Të përgatisë dokumentacionin shoqërues të pacientit dhe të zbatojë protokollin e transportit të pacientit drejt institucionit ku do i ofrohet shërbimi shëndetësor i specializuar.
- Të organizojë transportin e pacientit dhe të shoqëruesit të tij.
- Të ndjekë dhe kryejë procedurat për përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj ofruesit të shërbimit shëndetësor.

Kjo strukturë kryen cdo funksion tjetër të parashikuar në rregulloren e miratuar në zbatim të këtij ligji, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Neni 16

Fondi i Veçantë për financimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor

Në funksion të përballimit të shpenzimeve të trajtimit shëndetësor, për subjektet përfituese të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale parashikon një "Fond të Veçantë", çdo vit buxhetor.

Vlera e Fondit të Veçantë, do përcaktohet, referuar nevojave për trajtim shëndetësor të specializuar, të përfituesve nga ky ligj, të vitit paraardhës.

Ky fond do administrohet nga struktura administrative përgjegjëse e ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Fondi nuk mund të rishpërndahet për qëllime të tjera gjatë vitit buxhetor.

Neni 17

Shpenzimet që mbulohen nga Fondi i Veçantë

Fondi i Veçantë i planifikuar mbulon, sipas rastit:

- a) shpenzimet e trajtimit shëndetësor të specializuar të pacientit;
- b) shpenzimet e shtrimit spitalor;
- c) barnat dhe pajisjet mjekësore;
- ç) shpenzimet e udhëtimit për pacientin dhe një shoqërues ligjor.

Mbulimi financiar i trajtimit shëndetësor të specializuar kryhet përmes pagesës direkte institucionale.

Neni 18

Pamjaftueshmëria e Fondit të Veçantë

Në rast se fondi i veçantë i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor të specializuar brenda ose jashtë vendit, nuk përballon të gjitha rastet e miratuara për trajtim me Vendim të KTSHS-së, brenda ose jashtë vendit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bën kërkesë për fond rezervë, në bazë të ligjit "Për Buxhetin" të vitit buxhetor të miratuar me ligj.

Neni 19

Marrëveshjet ndërkombëtare

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për efekt të këtij ligji, ngarkohet të lidhë:

- a) marrëveshje dypalëshe;
- b) kontrata me institucione shëndetësore të specializuara të huaja;
- c) programe bashkëpunimi për trajtime shëndetësore të specializuara.

Neni 20

Transparenca dhe raportimi

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale publikon çdo vit:

- a) numrin e rasteve të trajtuara jashtë vendit;
- b) kategoritë e diagnozave;
- c) fondet e shpenzuara.

Të dhënat duhet të publikohen duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe anonimatit e pacientit.

Raporti vjetor paraqitet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar anonimatit.

Neni 21

E drejta e ankimit

Vendimi refuzues për trajtimin shëndetësor të specializuar brenda ose jashtë vendit, ankimohet në Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga subjektet përfituese të këtij ligji, jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e tij.

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shqyrton ankesën dhe merr vendim të arsyetuar brenda 5 ditëve.

Vendimi duhet të përmbajë analizë të kritereve të proporcionalitetit dhe bazën mjekësore të vlerësimit.

Vendimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ankimohet në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative.

Neni 22

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi.

Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin e rregullores, për funksionimin e strukturës administrative përgjegjëse të vendimeve të KTSHS.

Ky ligj zbatohet pa cënuar dhe duke plotësuar legjislacionin ekzistues “për kujdesin shëndetësor”.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELACION SHOQËRUES

PËR PROJEKTLIGJIN

**PËR FINANCIMIN SHTETËROR TË TRAJTIMEVE SHËNDETËSORE TË
SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT, BRENDA OSE JASHTË VENDIT, KUR ATO NUK
OFROHEN NGA SISTEMI PUBLIK I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

QËLLIMI DHE NEVOJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj synon të garantojë në mënyrë të qartë, të detyrueshme dhe të strukturuar financimin nga shteti të trajtimeve shëndetësore të specializuara për fëmijët 0–18 vjeç, në rastet kur këto trajtime nuk ofrohen nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon të drejtën e çdo shtetasi për kujdes shëndetësor nga shteti. Në mënyrë të veçantë, shteti ka detyrimin të mbrojë fëmijët si kategori e mbrojtur kushtetuesisht.

Gjithashtu, neni 24 i Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, detyron shtetet palë të sigurojnë nivelin më të lartë të mundshëm të shërbimeve shëndetësore për fëmijët.

Aktualisht, mungon një mekanizëm ligjor i posaçëm që të rregullojë në mënyrë të qartë:

- kriteret e përzgjedhjes,
- procedurën e vendimmarrjes,
- afatet e detyrueshme,
- burimin e financimit,

- dhe përgjegjësitë institucionale.

Kjo situatë ka sjellë vendimmarrje ad-hoc dhe pasiguri juridike për familjet.

GJENDJA AKTUALE DHE PROBLEMATIKA

Në praktikë, rastet e trajtimit jashtë vendit janë trajtuar përmes:

- vendimeve individuale administrative,
- fondeve të përgjithshme buxhetore,
- ose nismave private dhe donacioneve.

Mungesa e një fondi të dedikuar dhe e një komisioni të formalizuar ka krijuar:

- pabarazi në akses,
- vonesa në vendimmarrje,
- mungesë transparence,
- pasiguri për familjet në situata urgjente.

ZGJIDHJA QE JEP PROJEKTLIGJI

Projektligji krijon për herë të parë një mekanizëm të strukturuar dhe të detyrueshëm që përfshin:

1. Krijimin e Komisionit për Trajtimin Shëndetësor të Specializuar (KTSHS) pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Vendosjen e afateve të detyrueshme të vendimmarrjes:
 - 3 ditë për rastet e zakonshme;
 - procedurë e përshpejtuar për rastet me rrezik jetik.
3. Aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke balancuar:
 - nevojën jetike,

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës,
- legjislacionin për kujdesin shëndetësor,
- ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës,
- legjislacionin për buxhetin e shtetit.

Ai nuk cenon, por plotëson kuadrin ekzistues.

PËRFUNDIM

Ky projektligj synon të institucionalizojë një detyrim kushtetues dhe moral të shtetit shqiptar: mbrojtjen efektive të jetës dhe shëndetit të fëmijëve.

Ai vendos rregulla të qarta, procedura të detyrueshme dhe mekanizma transparence, duke garantuar një balancë të drejtë ndërmjet interesit më të lartë të fëmijës dhe përgjegjësisë financiare publike.







REPUBLIC OF ALBANIA

mobilefirst:surname

Demiraj

Entity Name
Mertil

NEJL

Shqiptare/Albanian

Karöö ALB

KUÇE, ALB
031 411 02 / 031 411 03

25-11-1984

data e shipment date

27-01-2021

MPR

110

nr. internofun/card no.

036871243

2/12/2008

M

data a skadimis/date of expiry

26-01-2031

nr. personal/personal no
T4112ED660

1411230660



I<ALB0368712432I41125066C<<<<<
8411257M3101263ALB<<<<<<<<<<7
DEMIRAJ<<NERTIL<<<<<<<<<<<<<<<<